



Gjakovë Rahovec Lumbarah <input type="checkbox"/>	13.06.201	Nr.: 1262
---	-----------	-----------

hidroing. i dipl. Shpejtim Hadri
udhëh. për zhvillim dhe planifikim

Faqe 33

METODOLOGJIT DHE TEKNOLOGJIT FRYMËZUESE

**Programi strategjik afatmesëm
i KRU "RadonIQI"
me studimin e realizueshmërisë**

Periudha 2011-2016

**Modeli i përcaktimit
administrativ**

Arsyetimi përmbajtjesor i këtij programi

KRU “Radoniqi”, nga propozim plani zhvillimor nr.1087 dt.10.04.2008, sipas procedurave të përcaktuara për investimet kapitale më me prioritet nr.1301 dt.06.05.2008, ka formuar listën programore të këtyre investimeve kapitale nr.1482 dt.30.05.2008, dhe me rishikimin e këtij planifikimi strategjik i prioritetëve për investime kapitale nr.1921 dt.25.09.2009, dhe ka renditur këto projekte me prioritet afatmesëm, në programin strategjik 2011-2016:

Projekti për ndërrimin e rrjetit të ujësjellësit për qytetin e Gjakovës, ku parashihet ndërrimi i gypave të vjetruar, ndërrimi dhe rekonstruktimi i pajisjeve dhe pjesëve fazonike, pusetave e tj. si njëri ndër parakushtet për funksionimin normal të sistemit të ujësjellësit dhe zvogëlimit të humbjeve të ujit nga gypat primarë rrugor, të cilat janë pasojë e materialit të papërshtatshëm të gypave të ujësjellësit dhe vjetërsisë së tyre.

Krahas ndërrimit të gypave primar rrugor, KRU “Radoniqi” ka paraparë edhe punimet për rehabilitimin e stacionit ekzistues të filtrimit dhe ndërtimin e fazës së II-të dhe në këtë mënyrë të rris cilësinë dhe sasinë e ujit të prodhuar, e cila tashmë veç është më se domosdoshme dhe ku do të tregohet në këtë program (Vëllimi vijues).

Gjithashtu, KRU “Radoniqi” planifikon të kryej punët rregulluese të kanalit derivues, të pa përfunduara që nga lëshuarja e tij në përdorim, rreth 2km, duke e renditur si punë të rëndësishme dhe të domosdoshme për rritjen e kohëzgjatjes funksionale të kanalit derivues e me këtë edhe të vet liqenit, akumulacionit artificial të Radoniqit

KRU “Radoniqi” nuk ka mjete financiare vetanake për mbulimin e këtij investimi kaq të madh, dhe duke parë se donacionet për këto investime kapitale strategjike për Komunën tonë dhe regjionin në përgjithësi, deri më tani kanë munguar dhe vazhdojnë të jenë të pashpresë, prandaj i lejova vetes që të provohet me dhëniet e sinjaleve të mira tek investitorët dhe huadhënësve të huaj se investimi në kompaninë tonë do të jetë i sigurt (ose jo!) dhe me këtë të mundësohet qasja në financimet nga jashtë.

Për këtë shkak iu përkushtova punimit të këtij studimi kaq kompleks, për të gjitha projektet ideore dhe ato nga programi për investimet kapitale, me bindjen se nga efekti i kapaciteteve të ngritura deri më tani dhe të një investimi për projektimet e së ardhmes, do të jemi në gjendje (ose jo!) të paguajmë rregullisht anuitetet për shlyerjen e kredive, në mënyrë që të krijojmë kushte për të arritur biznes fitimprurës për një periudhë të gjatë kohore. Këtë synim të KRU “Radoniqit” me siguri se do ta mbështesin edhe Qeveria e Republikës së Kosovës si themelues (MEF) dhe Qeveritë lokale të regjionit ku furnizojmë me ujë të pijshëm (KK e Gjakovës, KK e Rahovecit dhe KK e Prizrenit) të cilat si synime të veta më me rëndësi dhe si më esenciale duhet të tregohen të vendosura për ruajtjen e njërit (pothuaj të vetmit) resurs jetësorë dhe i pazëvendësueshëm si që është uji i pijshëm dhe rezervat e këtij resursi, e që ato të ruhen edhe për brezat e ardhshme për një periudhë kohore sa më të gjatë.

Strategjitë e deri tashme kanë qenë pothuaj të gabuara pasi që produktin natyror më të rëndësishëm dhe të pa zëvendësueshëm jetësor, e kanë klasifikuar në “kategori sociale”, ashtu që çmimet e shitjes së ujit të pijshëm janë aq të ulëta, sa që me to nuk mund të mbulohen shpenzimet bazike të prodhimit, përpunimit dhe furnizimit, se për shpenzimet e mirëmbajtjes, rivendosjes dhe të zgjerimit të kapaciteteve të mos flasim.

Sa për ilustrim, po japim disa të dhëna mbi çmimet e ujit tek ne, në KRU “Radoniqi” dhe tek ndërmarrjet tjera simotra në nivel vendi, të bashkërenditura me çmimet e ujit të disa vendeve të rajonit. Kështu p.sh. tek ne, e edhe në nivel vendi çmimi për një m³ ujë është 0,28-0,35 €. Ndërsa në nvendet e rajonit çmimet e një m³ ujë sillen prej: Mal të Zi 1,0-1.5 €/m³, Kroaci 0,75-1,0 €/m³, Maqedoni 0,5-1,0 €/m³, Bosnje e Hercegovinë 0,6-1,5€/ m³ dhe Hungari 0,8-1,4 €/ m³.

Nga sa u tha më lartë, aktivitetet e veta KRU “Radoniqi”, për periudhat e ardhshme kohore duhet ti përqendroj në drejtim të:

1. Racionalizimit të të gjitha aktiviteteve punuese;
2. Rritjes së efikasitetit ekonomik dhe nivelit të sigurisë
3. Mbrojtjes më të madhe mjedisore dhe të resurseve të ujit
4. Investimeve më të mëdha, në atë mënyrë që të kompensojmë të gjitha gabimet dhe lëshimet e deri tashme, dhe atë për të cilat na është pamundësuar gjatë 15-20 vitet e fundit, përgjatë luftërave të shpërbërjes së ish republikave RSFJ-së, përkeqësimit financiar të ndërmarrjes sonë dhe të popullatës së varfëruar.

Si do të mund të arrihej kjo? Cilat janë ato aktivitete? Çfarë masash duhemi të ndërmarrim?

Me masat e racionalizimit, do të përpiqemi me të gjitha mjetet e mundshme që të zvogëlojmë humbjet e ujit, që nga prodhimi e deri në furnizim - tek pikat ujë marrëse të konsumatorëve. Kjo do të arrihet me rekonstruktimin dhe ndërrimin e rrjetit të vjetruar, me rritjen e kapacitetit prodhues dhe me futjen në sistem të konsumatorëve ilegal dhe njëherit duke i konvertuar ata:

1. Pra me ndërrimin dhe rivendosjen e rrjetit të ri do të jemi në gjendje të zvogëlojmë humbjet e ujit në rrjetë për të paktën 25%, krahasuar me humbjet e përgjithshme aktuale prej 65%, të cilat po ti konvertojmë në vlera sipas kostove totale për prodhimin e 1m³ ujë të çmimit të tanishëm dhe duke i shtuar kostot e zvogëluara nga prodhimi i reduktuar, po që se do të zvogëlohej prodhimi (prodhimi do të zvogëlohej për sasinë e humbjeve që synojmë ti zvogëlojmë, dhe kjo do të ndodhte vetëm atëherë nëse nuk do të parashikonim zgjerime të rrjetave), në rastin tonë si shumë vjetore do të kurseheshin për tri vitet e para **1.305.000 €/vit**me tarifën e 2011, ndërsa pas tre vitesh **1.710.000 €/vit** me tarifa të ndritura për 30%.

$$18.000.000 \text{ m}^3/\text{vit} \times 25\% = 4.500.000 \text{ m}^3/\text{vit} \times 0.29 \text{ €/m}^3 = 1.305.000 \text{ €/vit}$$

$$18.000.000 \text{ m}^3/\text{vit} \times 25\% = 4.500.000 \text{ m}^3/\text{vit} \times 0.38 \text{ €/m}^3 = 1.710.000 \text{ €/vit}$$

2. Rritja e efikasitetit ekonomik do të siguronim rritje të të hyrave tona në këto dy mënyra:

- Me futjen në sistem të një numri të konsiderueshëm të shpenzuesve të cilët në rrjetin e sistemit tonë të ujësjellësit janë kyçur ilegalisht. Ata mund të shfrytëzojnë kyçjen si të vetme apo si furnizim kryesor e gjithashtu mund të supozojmë se gjysma tjetër ka si kyçje të dytë para ujëmatësit. Sipas vlerësimeve tona, numri i konsumatorëve që shërbehen me kyçje ilegale mund të sillet rreth 3000 amvisëri dhe 200 lokale afariste. Pra 1500 amvisëri dhe 100 lokale afariste me kyçje të vetme ilegale dhe po aq me kyçje të dyfishtë para ujëmatësit. Duke supozuar se ato gjatë 2-3 viteve të ardhshme gjysma e tyre do të legalizohen si të rregullt dhe gjysma e tyre do të shkyçen, ne do të mundë të realizonim rritje të të hyrave për **267.600 €/vit** mu nga shpenzimi i lexuar me ujëmatje me tarifën e 2011 ndërsa pas tre vitesh me tarifën e ngritura **350.400 €/vit** dhe do të arrinim zvoglim shtesë të humbjeve, nga humbjet totale, për 744.000 m³/vit, që në përqindje i bie rreth 5.3%. Të hyrat e mundshme vjetore:

$$3000 \times 200 \text{ m}^3/\text{vit} = 600.000 \times 0.29 = 174.000 \text{ €/vit (amvisëritë)}$$

$$200 \times 720 \text{ m}^3/\text{vit} = 144.000 \times 0.65 = 93.600 \text{ €/vit (bizneset)}$$

$$3000 \times 200 \text{ m}^3/\text{vit} = 600.000 \times 0.38 = 228.000 \text{ €/vit (amvisëritë)}$$

$$200 \times 720 \text{ m}^3/\text{vit} = 144.000 \times 0.85 = 122.400 \text{ €/vi (bizneset)}$$

- Me konvertimin e tyre (me kyçje ilegale të vetme) në konsumatorë të rregullt, sipas rregullit fillimisht ata do të duhej të paguanin për shfrytëzimin e ujit pa e kontraktuar më parë, 100€ për amvisëritë (që i bie 1500 x 100 = 150.000€) dhe 300€ për bizneset (100 x 300 = 30.000€), pra nga konvertimi i tyre në fund të periudhës investive do të kemi gjithsejtë 180.000€, dhe pagesën e tarifës për kyçje 58€ (që i bie 58 x 1600 = 92.800€) që për çdo vit i bie (sipas realizimit të investimeve në ndërrimin e rrjetave): 180.000 : 3 = **60.000 €/vit**

- Në sistemin e ujësjellësit, nga gjithë regjioni vlerësohen të jenë rreth 320 konsumatorë social, por edhe disa herë më shumë se kaq me pamundësi investive për mirëmbajtjen e rrjetave të tyre të mbrendshëm, dhe nga të cilët shumica e tyre edhe nuk kanë ujëmatësia, çeshmet e tyre rrjedhin gjatë gjithë kohës e sidomos gjatë periudhave me ngrica (dimrit) që të mos u ngrijnë gypat. Kësaj kategorie do tu instalonim ujëmatësit për leximin e shpenzimit, e në këtë mënyrë do ti kishim nën kontroll. Kjo mund të kalkulohej si rreth 1000 konsumatorë nga një çeshme me rrjedhje sado të pakët do të kishim rrjedhje prej 91.454 : 3 = **30.484 €/vit**

$$1000 \text{ konsumatorë} \times 1 \text{ çeshme} \times 0.01 \text{ l/sec} = 864 \text{ m}^3/\text{vit} \times 365 = 315.360 \text{ m}^3/\text{vit} \times 0.29 = 91.454 \text{ €/vit}$$

- Dhe së fundmi me këtë nismë do të arrihej edhe efekti i nivelit të sigurisë për cilësinë e ujit, me kushtëzimin e atyre që kanë kyçje të dyfishta, nga sistemi ynë dhe nga nga pusët vetanake, si preventiva të vetë furnizimit dhe pa valvula siguruese (jokthyes) uji i të cilëve nuk kontrollohet, ashtu që ekziston mundësia e ndotjes së ujit në rrjetin tonë, me ç'gjë rrezikohet shëndeti i tyre dhe i konsumatorëve tjerë në sistem. Këtyre rasteve do tu imponohej çkyqja (ndarja) e furnizimit preventiv ose sigurimi me instalimin e valvulave jo kthyes, sipas rregullave dhe standardeve.

- Me rritjen e investimeve do të ndikojmë në ngritjen e efikasitetit dhe të performancës në përgjithësi, dhe të zvoglimit të humbjeve për 32.5% (nga rekonstruktimi/ndërrimi i rrjetave 25%, nga futja në sistem e konsumatorëve ilegal 4% dhe nga rregullimet e rrjedhjeve në instalimet e brendshme 2%).

Nr	m ³ /vit	%	€/vit
1	4,500,000	25	1,305,000
2	1,059,360	6	538,454
2.1	744,000	4	267,000
2.2		0	180,000
2.3	315,360	2	91,454
Shuma:	5,559,360	31	1,843,454

II. Qëllimi, historiku i ndërmarrjes, lokacioni dhe shtrirja hapësinore dhe përshkrimi i gjendjes ekzistuese të objekteve

Qëllimi

Ofruesi i shërbimeve për furnizim me ujë dhe kanalizime **KRU Radoniqi – SH.A.** për regjionin Gjakovë-Rahovec-Lumbardhë, kërkon ndihmë financiare për përgatitjen dhe kryerjen e projekt-programit të sistemit të ujësjellësit dhe të kanalizimit.

Gjithashtu kërkon ndihmë për identifikimin e institucioneve potenciale, financuese që do të kenë mundësi të financojnë në këtë program për investimet kapitale.

Synimi kryesor i këtij plani është përgatitja e projekt planit afatmesëm për përmirsimin e shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimeve të ndërmarrjes KRU “Radoniqi”- Regjioni jug-perëndimor i Kosovës, (Gjakovë, Rahovec dhe Lumbardhi)

Historiku i ndërmarrjes

Fillimi i punimeve për ndërtimin e sistemit të furnizimit me ujë nga liqeni i Radoniqit daton nga fillimi i viteve '80-ta. Për furnizim me ujë të qyteteve të Gjakovës dhe Rahovecit është ndërtuar gyp-sjellësi kryesor transportues gravitacional nga SF, me rezervuar të përbashkët 2x5000m³, deri te ndarja për Gjakovën gyp GRP Ø1100 e më pas vazhdon me Ø800 deri te ndarja për Rahovecin. Rrjeti shpërndarës në qytetin e Gjakovës, para-lagjet dhe fshatra, suksesivisht janë ndërtuar dhe ndërtohen që nga vitet e '60-ta, gjatësia e tërë bashkë me kyçjet sillet aproksimativisht rreth 550km, me përqindje shumë të madhe të gypave AC.


Kaptazha në liqenin e Radoniqit është burimi kryesor dhe i vetmi për furnizim. Liqeni “Radoniqi” mbushet nga ardhjet e lumit Lumbardhi (Bistrica) nga portat e pragut për hapje – mbyllje të rregullimit të prurjeve që përmes kanalit të betonit në formë trapezi me kapacitet 12 deri 15 m³/sec (i papërfunduar edhe 2km) bëhet mbushja e liqenit kryesisht sezonale, ashtu si që është dedikuar. Uji i liqenit shërben edhe për ujitjen e më shumë se 5000 ha, për agro-kulturë.

Kompania rajonale e ujësjellësit. furnizon mbi 220.000 banorë, të cilët përfshihen në shërbimet tona. Sistemi i ujësjellësit dhe kanalizimit është nën menaxhimin e KRU Radoniqi-SH.A. me seli në Gjakovë, me shtrirje gjeografike Jug-Perëndim të Kosovës, në lokacionet e komunave të Gjakovës, Rahovecit dhe Lumbardhit (Komuna e Prizrenit), pellgu i lumit Drini i bardhë, si kompani publike nën kontrollin MEF-it, Qeveria e Kosovës, si aksionar.

Furnizimi me ujë bëhet nga kapja e ujit të liqenit Radoniqi, me këto procese tretmani: paraklorinimi, flokulimi, fundërrimi (pulizimi), filtrimi dhe klorinimi. Kapaciteti për fazën e parë është projektuar për deri 500l/sec. Me rritjen e konsumatorëve dhe me rritjen e standardit jetësor kërkesat ujore janë rritur (>700l/sec). Menaxhimi i kërkesave për ujë është vështirësuar që nga prodhimi e deri te distribuimi, e kjo sidomos gjatë kohës me thatësira të tej zgjatura. Gjithashtu edhe në kohën e stratifikimit në liqe shfaqet nevoja e përdorimit të karbonit aktiv, e që pamundëson këtë prodhim të rritur të ujit.

Kyçja e fshatrave vazhdon, e shumë prej tyre kanë qenë paraparë për fazën e dytë. Prodhimtaria vjetore e ujit është rreth 18mil. m³/vit. Humbjet e ujit janë preokupim parësor për ndërmarrjen tonë e që sillen rreth 11-12mil. m³/vit (rreth 65%). Mbledhja dhe largimi i ujërave të zeza/përdorura bëhet me gravitacion me derdhje nëpër recipientët më të afërt pa ndonjë trajtim. Gjatësia e kanalizimit fekal sillet rreth 56km, kurse kolektori kryesor rreth 5,7km. Disa para-lagje dhe shumë fshatra tash për tash nuk kanë kanalizim fekal.

Lokacioni dhe shtrirja hapësinore



Gjendja ekzistuese e objekteve

Në sistemin e ujësjellësit KRU “Radoniqi” ka 7 SP, 12 Rezervuar, 553.388 m gypa të dimensioneve dhe materialeve të ndryshëm, prej tyre nga AC -132.630 m, PVC – 14.762 m, Metalik – 4.946 m, nga GRP – 22.303 m dhe nga PE - 393.954 m.



Shtrirja gjeografike e
KRU “Radoniq”-it
(vija e lakuar me ngjyrë të gjelbërt)

Shumica e rrjetave të ujësjellësit janë me diametër jo adekuat në raport me nevojat e furnizimit për kërkesat e rritura, materialet e përdorura janë të papërshtatshëm dhe problemin më të madh e paraqesin gypat e stër-vjetruar të AC, të gusit me vazhdim të plumbit të shkrirë në mufë si dhe gypat e zingtuar të cilët nga pakujdesia apo nga mosdija janë përdorur edhe ata me më pak se 5bara dhe se gjendja e tyre fizike është pafundësisht e pakënaqshme. Pra, shumica e këtyre gypave të stër-vjetruar duhet të ndërrohet, pasi që humbjet e ujit në sasi më të madhe i kemi emërtuar shkakut të rrjetit të vjetruar.

Pjesë e veçantë e rrjetit shpërndarës janë nyjet dhe hidrantët. Duke pas parasysh rrethanat e papërshtatshme të rrjetit të vjetër, në sistemin e ujësjellësit ekzistojnë një numër mjaft i madhë i nyjeve me puseta të cilat gjithashtu janë të papërshtatshme dhe jo funksionale. Në përbërje të nyjeve janë rreth 700 valvula, 60 hidrantë kundër zjarrit dhe më se 10 pika lëshuese për shplarjen e rrjeteve. Gjendja fizike e nyjeve assesi nuk është e kënaqshme, kurse humbjete e evidentuara të ujit më së shpeshti paraqiten mu nëpër këto nyje.

Pra për shkak se humbjet janë caq të mëdha, 65% si të evidentuara, ne mund të konstatojmë se në sistem një pjesë e saj shpenzohet pa u regjistruar dhe të cilat duhet ti paraqesim si “humbje objektive” dhe pjesa tjetër na paraqiten si pasoj e rrjetit të vjetruar si “humbje subjektive”, dhe ne duam që ti eliminojmë ato, ose në një masë të madhe, bile ti zvoglojmë ato.

Në “humbje objektive” sipas terminologjisë së sistemeve të ujësjellësit do ti fusim:

- Uji i shpenzuar për shpëlarjen e rrjetave nga arsytet sanitare-teknike
- Uji për shplarjen e filtrave, si pjesë e teknologjisë për trajtimin e ujit
- Shpenzimet komunale, të cilat nuk maten që janë: shpenzimi nga çeshmet publike, për shplarjen e rrugëve, fontana dhe pagesat tjera paushalle pa matje të ujit.

Në “humbjet subjektive” do ti fusim:

- Humbjet e ujit nga vjetërsia e gypave, nyjeve dhe hidrantëve
- Humbjet në ujëmatës
- Manipulimet me ujëmatës dhe/ose shfrytëzimi i ujit para ujëmatësave
- Humbjet nga avarit dhe intervenimet për shkak zbulimit jo me kohë të vendeve të plasaritjeve-çarjeve në gypa

Përvojat e vendeve perëndimore tolerojnë humbje të ujit në rrjetin shpërndarës 15–20%. Tek ne këso normash nuk ka, por nëse kërkohet nga përvojat e krijuara të mëhershme dhe të tanishme, këto humbje, do të ishin të tolerueshme edhe 25-30%, për një kohë derisa të krijoheshin kushte më favorizuese për ndërmarrjet e ujësjellësit. Pra përfundimisht, gjithsesi mund të konkludojmë se humbjet e ujit në nivelin aktual janë të pa tolerueshme.

Zvogëlimi i humbjeve në KRU “Radoniqi” tashmë është aktivitet afatgjatë me objektivat e precizuara, e me format dhe mjetet për ta trajtuar këtë problem. Për këtë shkak, KRU “Radoniqi” ka nevoj të bëjë ndërrimin e rrjeteve të ujësjellësit, në një pjese të madhe (në fazën e parë rreth 30km) të bëjë revizionin e nyjeve (mbi 290 pusetave) dhe të montoj kapësit e papastërtive, shplarësit e rrjetave dhe të një numri të madh të hidrantëve. E gjithë kjo na bënë të konstatojmë se kemi të bëjmë me vëllim të madh të punëve, punime afatgjate dhe të kushtueshme, efektet e së cilës vlerësohen në zvogëlimin e humbjeve të ujit nga humbjet aktuale prej 65% në rreth 34%.

II.1 Të dhënat mbi investitorin - KRU Radoniqi

Sipas këtij programi, investitor është Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Radoniqi” – Gjakovë, rruga e UÇK-së nr.7. Ndërmarrja për prodhimin dhe distribuimin e ujit të pijshëm për regjionin Gjakovë, Rahovec dhe Lumbardh, ekziston nga viti 1985, ndërsa me vendimin e Qeverisë së Kosovës- Ministria e Tregëtisë dhe Industrisë nr. 70392902 dt. 14.11.2006 ka regjistruar KRU “Radoniqi”-in si Ndërmarrje Publike deri në privatizim, e themeluar për prodhimin dhe distribuimin e ujit të pijshëm dhe për largimin e ujrave të zeza.

Kompania rajonale e ujësjellësit Hidrosistemi “Radoniqi” Sh.A. (në vazhdim KRU “Radoniqi”) ka 27.850 konsumatorë (30.10.2010) me rreth 230.000 banorë, të cilët përfshihen në shërbimet tona. Sistemi i ujësjellësit dhe kanalizimit është nën menaxhimin e KRU “Radoniqi” me seli në Gjakovë, me shtrirje gjeografike Jug-Perëndim të Kosovës, në pronësi të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nën kontrollin e Ministrisë së Financave dhe ZRRUM-i si rregullator dhe udhëzues i kompanive ujore, e poashtu edhe me mbikqyrje nga Bordi i Drejtorëve.

Furnizimi me ujë bëhet nga liqeni i Radoniqit, me këto procese trajtimi: paraklorinimi, flokulimi, fundërrimi (pulizimi), filtrimi dhe klorinimi. Kapaciteti për fazën e parë është projektuar për 500 l/sec, ndërsa aktualisht prodhimi arrin edhe deri në 700 l/sec. Me rritjen e konsumatorëve dhe me rritjen e standardit jetësor kërkesat ujore janë rritë vazhdimisht. Menaxhimi i kërkesave për ujë është vështirësi që nga prodhimi e deri te distribuimi, e kjo sidomos gjatë kohës me thatësira. Poashtu edhe në kohën e stratifikimit në liqe çfaqet nevoja e përdorimit të karbonit aktiv, e që pamundëson prodhim të ujit sipas kërkesave maksimale si dhe zvoglon ujin e prodhuar për distribuim, për shkak të shplarjes së domosdshme në numër dhe sasi më të madhe.

Prodhimtaria vjetore e ujit është rreth 18mil. m³/vit. Humbjet e ujit janë preokupim parësorë për ndërmarrjen tonë e që sillen rreth 11mil. m³/vit (~ 65%).

II.2 Struktura organizative

KRU "Radoniqi"-Sh.A. është i organizuar sipas metodave të kohës, të cilën po e prezantojmë me skemën organizative të mëposhtme:


1. Shërbimi për përpunimin dhe distribuimin e ujit të pijshëm
2. Shërbimi për mbledhjen dhe largimin e ujërave të përdorura
3. Shërbimi për mirëmbajtje dhe intervenime në rrjetën e ujësjellësit
4. Shërbimi për furnizime
5. Shërbimi për inkasime
6. Shërbimi për punët e llogari-mbajtjes dhe financat
7. Shërbimi kadrovik, për punët e përgjithshme administrative dhe për marrëdhëniet me publikun.

KRU "Radoniqi"-Sh.A. ka Bordin e Drejtorëve, të cilin e emron Qeveria e Republikës së Kosovës, si themelues i kompanisë dhe si i vetmi aksionarë, dhe Kryeshefin ekzekutiv, të cilin gjithashtu e emëron....

Duke u njohur me përgatitjen profesionale dhe me përvojat shumë vjeçare, mund të konstatohet se menaxhmenti i kompanisë është i aftë që me sukses të udhëheqë dhe të drejtoj proceset e punës dhe të menaxhimit, që nga afër mund të vërehet nga përshkrimet dhe pasqyrat e strukturës kualifikuese si më poshtë.

Ekipin menaxhues e përbëjnë:

1. Kryeshefi ekzekutiv
2. Menaxheri financiar
3. Menaxher i administratës, dhe
4. Menaxheri për prodhim, operativë, zhvillim, ujësjellës dhe kanalizim.



Udhëheqja e KRU “Radoniqi” punët e veta i kryen me punë ekipore dhe me të drejtë kujdesin e vetë e orjenton në drejtim të angazhimit dhe të shfrytëzimit sa më racional të resurseve të veta me të cilat disponon.

Në këtë aspekt, aktivitetet e tyre janë të orjentuara në drejtim të angazhimit të të gjithë spektrit profesional me të cilat disponon KRU “Radoniqi”.

Që ti përafrojmë aktivitetet e tyre punuese me shfrytëzuesit e këtij plani zhvillimor afatmesëm, studimi mbi realizueshmërinë e këtij plani, do ti cekim disa nga punët më të rëndësishme e të cilat duhet ti synojmë:

- Pruarjen e vendimt mbi aftësimin e të gjithë të punësuarëve, e veçanërisht kuadrove të aftësuar dhe më me përgjegjësi, asisoj që me shfrytëzimin e këtij resursi të rëndësishëm (fuqisë punëtore dhe kapitalit intelektual), sa më shumë të kontribuohet në zgjidhjet e ndërrimeve zhvillimore dhe të informacioneve të reja për përparimet teknokoteknologjike dhe ekonomiko-financiare.
- Pruarjene e vendimeve të rëndësishme planifikuese dhe zhvillimore në bashkëpunim me Bordin e Drejtorëve dhe Themeluesin.
- Definimi i drejtimeve zhvillimore dhe përvetsimin e zgjidhjeve të reja ose zgjidhjeve inovatore, përfshirë këtu shfrytëzimin e zgjidhjeve nga njohurit dhe nga përvojat praktike dhe të sotshmet si më bashkëkohore.
- Krijimin e kushteve për kryerjen e ndërrimeve të domosdoshme dhe besimin e punëve më të rëndësishme tek ata që janë profesional dhe kompetent, qoft person apo ekip, pas të cilëve ekzistojnë informacione të besueshme dhe me rezultate konkrete.

Të gjitha këto punë dhe aktivitete tjetra mundë të shiqohen në faqet vijuese të këtij studimi mbi realizueshmërinë e këtij programi afatmesëm zhvillimorë.

II.3 Struktura kualifikuese e të punësuarëve (31.12.2010)

KRU “Radoniqi” në fundvitin 2010, ka këtë strukturë të të punësuarëve:

Nr.r.	Kualifikimi	Numri	Femra	Meshkuj
1.	Me kualifikim magjistër	4	-	4
2.	Me kualifikim të lartë	19	3	16
3.	Me përgatitje të lartë shkollore	9	2	7
4.	Me përgatitje të mesme shkollore	135	13	122
5.	Me përgatitje fillor	51	6	45
	GJITHSEJT:	218	24	194

Për shkak të vëllimit të madh të punimeve dhe nivelit të rritur të përgjegjësive për secilin, por edhe për redukimin e gabimeve të mundshme në punët dhe aktivitetet e kompanisë, është e nevojshme të përmirsohet struktura e kualifikimit, duke punësuar disa nga ata me përgatitje profesionale fakultative, me përgatitje të lartë ose të mesme shkollore për punimet në teren si udhëheqësa grupesh dhe fuqi punëtore të kualifikuar. Njëkohsisht në masë të njëjtë, gradualisht të zvoglohet numri i strukturave tjera, gjithsesi i atyre që vit pas viti i përmbushin kushtet për pensionim. Gjithashtu, numri i punëtorëve të “tepërt” mund të zgjidhet me rritjen ekonomike nga vëllimi i shtuar i punimeve, jo vetëm nga zgjerimi i punëve të mirëmbajtjes por edhe nga zgjerimi me rrjeta të reja të ujësjellsit në gjatësi prej 30 km dhe punimesh tjera të përfshira me këtë studim.

III. Punët përgatitore për studimin detal

Punët përgatitore për programin strategjik afatmesëm 2011-2016 kanë qenë të gjitha ato punime të cilat përfshijnë punët teknike, financiare, juridike, socio-ekonomike ose institucionale, si dhe ndikimet mjedisore, e që kanë qenë të përgatitura nga KRU “Radoniqi”, në nivelin ideor e që janë në fazën përgatitore, por të njëjtat duhet të projektohen për ekzekutim, e që kanë të bëjnë me shërbimet tona të furnizimit me ujë, për qytetin e Gjakovës dhe për regjionin.

Ky studim do të jetë efektiv në programin investiv afatmesëm e që njëherit është edhe pjesë përbërse e planit zhvillimor afatgjatë.

Përgatitja e studimit të këtij planifikimi do duhej zhvilluar në dy faza:

Faza 1 që përbëhet nga:

- Përgatitja e studimit detal mbi nevojat e këtij programi, të cilat paraqesin performancën e tanishme financiare dhe operative të ndërmarrjes, me të dhënat socio-ekonomike, strukturat institucionale, nevojat dhe strategjitë për investime afatgjata ashtu që të mundësoj identifikimin dhe vërtetësin e nevojave për investimet primare afatshkurtra dhe afatmesme.
- Përgatitja e dokumentacionit të projekteve, mes tjerash edhe vlerësimi i tyre, projekcionet financiare të projekteve, vlerësimin e efektivitetit të projekteve për mjedisin, planet e investimeve dhe implementueshmërinë e tyre.
- Identifikimi i punëve që kompania jonë duhet ti ndërmerr për të përmirësuar performancën vetanake financiare dhe operative, për t’ia bashkëngjitur planit të investimeve dhe planit për implementueshmërinë e atyre projekteve
- Identifikimi i opsioneve potenciale për financim ose bashkëfinancim.
- Përgatitja detale e TOR-it konsultativ në shërbim të fazës 2.

Faza 2 që përbëhet nga:

- Punët hulumtuese/kërkimore me të cilat do të identifikoheshin investimet në Fazën 1.
- Përgatitja e dokumenteve për shqyrtimin e disa komponenteve nga programi.
- Programi implementues në favor të përmirësimit të performancës financiare dhe operative.

Në këtë kontekst, unë fillimisht do të provoj të ofroj një fazë më vete, ku mund të përfshiheshin disa nga punët e Fazës 1, por në fund të fundit le të quhet edhe si fazë konsultative, që do të shërbenin për të matur impulsin e vendim marrësve në angazhimet e fazave tjera. Në këtë fazë “konsultative” do të mundohem të ofroj:

- Ndhimesën themelore, ku mundë të vlerësohej situata e potencialit financiar dhe për të cilën do të mundë të bihej vendimi për financimin e tyre;
- Planin për përmirësimin e performancës financiare dhe operative të ndërmarrjes; dhe
- Ndhimesën për të bërë më të mundëshëm identifikimin e fondeve financiare ose kredive.

Në bazë të këtij punimi, detalet mbi vet projektin do të kontrakttoheshin ndërmjet Kompanisë-Themeluesit, Kompanisë-Komunës ose Regjionit, kurse projekt-programi do të përfaqësohej nga financuesi potencial.

IV. Vëllimi i punëve

IV.1. A: Vlerësimi i performancës financiare të ndërmarrjes

Aktivitetet e punës së deritashme të kompanisë KRU “Radoniqi” më së miri mund ti vlerësojmë nga këta tregues financiar

IV.1. A1: Pasqyrat financiare

		2007	2008	2009
Pasuritë				
Pasuritë jo qarkulluese				
Toka			8,617,300.00	8,617,300.00
Ndertesat			12,174,967.84	11,965,345.01
Inventari ,paisjet dhe makinat			15,634,623.10	15,103,007.89
Pasuritë e dhëna në lizing				
Investimet afatgjata				
Depozitat e afatizuara				
Totali i pasurive jo qarkulluse		37,166,077.74	36,426,890.94	35,685,652.90
Pasuritë qarkulluese				
Stoqet neto			502,206.94	712,295.43
Llogarit e arketueshme			936,895.21	1,247,415.47
Kerkesat tjera			16,194.90	27,447.80
Parapagimet				
Paraja dhe ekuivalentet e parase			328,456.10	287,465.82
Totali i pasurive qarkulluese		1,029,256.92	1,783,753.15	2,274,624.52
GJITHSEJT PASURIT JO QARKULLUESE DHE QARKULLUESE		38,195,334.66	38,210,644.09	37,960,277.42
Ekuiteti dhe rezervat				
Kapitali i emituar			25,000.00	25,000.00
Rezervat e rivlersimit			37,963,555.04	37,963,555.04
Fitimi/Humbja e akumuluar			-408,386.02	-943,194.95
Fitimi/Humbja e vitit			-534,808.93	0.00
Totali i ekuitetit dhe rezervave		37,070,786.61	37,045,360.09	37,045,360.09
Detyrimet				
Detyrimet jo qarkulluese				
Detyrimet afatgjata			83,975.89	124,430.91
Grantet e shtyera			6,101.67	232,362.88
Totali i detyrimeve jo qarkulluese			90,077.56	356,793.79
Detyrimet qarkulluese				
Llogarit e pagueshme dhe te tjera			275,939.15	231,832.92
Tatimet e pagueshme			683,023.13	787,514.45
Shpenzimet akruale			116,244.16	126,859.65
Totali i detyrimeve qarkulluese			1,075,206.44	1,146,207.02
Totali i detyrimeve jo qarkulluese dhe qarkulluese		1,124,548.05	1,165,284.00	1,503,000.81
GJITHSEJT EKUITETI DHE DETYRIMET		38,195,334.66	38,210,644.09	38,548,360.90

IV.1. A2: Pasqyra e të hyrave dhe të dalave

	2007	2008	2009
Te hyrat nga Shitja e Ujit		2,461,808.83	2,541,624.27
Te hyrat tjera		86,682.46	74,676.34
Zvogluar për: Lirimet në shitje			
Shitjet e kthyera			
Shitjet neto			
Shpenzimet e mallërave të shitura			
Fitimi Bruto	2,774,025.95	2,548,491.29	2,616,300.61
Shpenzimet operative :			
Shpenzimet e pagave		-1,155,354.25	-1,284,373.31
Shpenzimet e riparimeve dhe mirembajtjes		-63,405.66	-36,016.63
Shpenzimet administrative & telefonit		-28,401.04	-25,732.59
Shpenzimet e rrymes elektrike		-130,483.65	-139,436.12
Shpenzimet e derivateve		-59,821.09	-44,423.17
Shpenzimet e kemikaleve		-84,166.26	-40,384.84
Shpenzimet e marketingut		-19,231.32	-10,581.92
Shpenzimet borxheve e keqija dhe te dyshimta		-615,452.25	-665,905.48
Shpenzimet e zhvlersimit		-754,445.32	-753,557.46
Shpenzimet tjera operative		-177,400.68	-207,188.62
Totali i shpenzimeve operative	-3,184,553.93	-3,088,161.52	-3,207,600.14
Të ardhurat operuese	2,141.96	4,861.30	3,216.05
Të ardhurat tjera			
E ardhurat nga dividenda			
E ardhura nga interesi		4,861.30	3,216.05
Shpenzimet tjera			
Shpenzimet e interesit			
Shpenzimet nga tatimi në fitim			
Fitimi/Humbja e vitit	-408,386.02	-534,808.93	-588,083.48

Për të analizuar efikasitetin operativ dhe nivelin e zvogëlimit të shpenzimeve, duhet të ofrojmë një bazë solide nga e cila do të vareshin projeksionet financiare, dhe konsulenti do të përgatis specifikimin detal të shpenzimeve dhe të hyrave:

- Detalet e tarifave dhe të hyrave për të gjitha kategorit e konsumatorëve në periudhën kohore nga tri vitet e fundit
- Detalet e shpenzimeve operative në shërbimet e ujësjellsit dhe të kanalizimit, me shpenzimet fikse dhe variabile për secilën kategori
- Detalet mbi asetet, vërtetimi i vlerës së zbritur për secilën kategori të asetit, pra edhe metodologjin e përlllogaritjes. Vlerësimi adekuat i zhvlerësimit.
- Analiza e shpenzimeve shtesë, posaçërisht nga tatimet dhe kamatat

IV.1. A3: Pasqyra e rrjedhjes së parasë

	Shënimet	2007	2008	2009
Rrjedha e arkes nga aktivitetet operacionale				
	Fitimi/Humbja para tatimit		-534,808.93	-588,083.48
<i>Pershtatur nga :</i>				
	Te hyrat nga grantet			
	Te hyrat financiare		-4,861.30	-3,216.05
	Zhvlersimi		0.00	753,557.46
	Lejimet per borxhet e keqija		0.00	665,905.48
Fitimi operativ para ndryshimit ne kapitalin punues				
<i>Ndryshimi ne kapitalin punues:</i>				
	Stoqet		61,661.50	-210,088.49
	Llogarit e arketueshme , dhe te arketueshmet tjera tregtare		-841,758.92	-987,678.64
	Detyrimet tjera tregtare		40,735.95	337,716.81
Rrjedha e arkes nga aktivitetet operacionale				
			-739,361.47	-860,050.32
Rrjedha e arkes nga aktivitetet investuese				
	Blerja e pasurive jo qarkulluese		-15,258.52	-12,319.42
	Arketimet nga shitja e pasurive jo qarkulluese			
	Interesi i arketuar			
	Dividenda e pranuar			
Rrjedha e arkes nga aktivitetet operacionale				
			-15,258.52	-12,319.42
Rrjedha e arkes nga aktivitetet financuese				
	Arketimet prej emitimit te aksioneve			
	Rezultati nga huamarrja			
	Pagesa e detyrimeve për lizingun			
	Dividenda e paguar			
	Te hyrat financiare		4,861.30	3,216.05
Rrjedha e arkes nga aktivitetet financuese				
			4,861.30	3,216.05
Ndryshimet neto te parase dhe euivalentet e parase				
			-1,289,428.92	-40,990.28
Paratë e gatshme në fillim të periudhës				
			247,987.45	0.00
Paratë e gatshme në fund të periudhës				
			-1,041,441.47	-40,990.28

V. Analiza e tregut

Shikuar nga aspekti ekonomik, analiza e tregut ka rëndësi për Donatorin ose Investitorin që tu mundësohet të analizojnë aftësinë e vazhdueshme në kërkim të zgjerimit të tregut, me mbledhjen, rregullimin dhe përpunimin e këtyre të dhënave të shikojnë mundësin e paraqitjes së konkurrencës ose për futjen e ndonjë strategjie të re të biznesit.

Për studimin e realizueshmërisë të investimeve edhe nga Donatori/Investitori do të kërkohen përgjigje në këto pyetje:

1. Sa konsumator janë momental, cilët kategori janë ata si dhe sa është numri i tyre potencial për të ardhmen, të cilët do të paraqiten me mbarimin e investimit?
2. Sa ndikon te konsumatori çmimi dhe shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, si dhe a është ky shërbim dhe produkt i domosdoshëm apo paraqet një lloj luksi?

3. Cili është sistemi i rregullimit të pagesave për obligimet e kontraktuara ndaj shfrytëzuesve të shërbimeve tona?

Me përvetësimin e këtyre të dhënave, (të cilat do të kërkohen nga Donatori/Investitori) do të vazhdohet me analizën e konsumatorëve dhe numrit të tyre, si dhe nevojave të tyre për sasinë e caktuar të furnizimit me ujë dhe shërbime, duke marrë në konsideratë edhe aftësinë e tyre konsumuese po ashtu edhe mundësinë e shlyerjes së faturave mbi shfrytëzimin e shërbimeve dhe të nevojave të kontraktuara.

Donatori/Investitori vëmendje të posaçme do ti kushtoj profilit aktual dhe potencial të konsumatorëve dhe aftësisë së tyre konsumim/pagesë. Sipas të dhënave të KRU “Radoniqi” në mbarim të vitit fiskal 2010 numri i konsumatorëve të cilët shfrytëzojnë ujin dhe shërbime tjera janë gjithsejtë 27.850, prej tyre amvisëri 24.3015, shitore 3169, ente 212 dhe industri 154 konsumatorë. Konsumatorë potencial sillen deri në 3.000 amvisëri.

Numri i konsumatorëve të cilët më rregullisht i kryejnë obligimet e veta dhe shkalla e pagesave të faturave mund të vlerësohet 70-75%, e cila duke pasur parasysh rënien e aftësisë ekonomike të popullatës, mund të vlerësohet si deri diku e kënaqshme.

V.1. Strategjia e tregut

Strategjia e tregut përfshinë masat programore të cilat investitori, KRU “Radoniqi” i ndërmerr me qëllim të përmbushjes së nevojave të konsumatorëve të vet dhe për ata potencial, të cilën do ta tregoj edhe plan programi afatmesëm për investime, i futur në këtë studim mbi realizueshmërinë apo fisibilitetin e këtyre projekteve.

V.2. Strategjia e çmimeve

Duke pasur parasysh që KRU “Radoniqi” nuk vendos vet për çmimet, por këtë e bënë përmes marrjes së pëlqimit nga ZRRUM-i, për shkakun se kemi të bëjmë me produkt dhe shërbime specifike (uji i pijshëm), prap se prap strategjia e çmimeve doemos duhet të përmbajë këto elemente:

1. Në kalkulim duhet të përfshihen të gjitha shpenzimet, ashtu që të mund të përcaktohen çmimet e shitjes.
2. Politika e çmimeve për KRU “Radoniqin” do të vërtetohet edhe nga aspekti i kamatës për shpenzime investuese si mjete të huazuara – kreditë,
3. Për përcaktimin e politikave mbi çmimet, KRU “Radoniqin” duhet të nisët nga uji sa më cilësor për pije dhe largimin e ujërave të përdorura, si dhe nga aktivitetet të cilat duhet të ndërmerren me qëllim të mbrojtjes së mjedisit dhe resurseve ujore.
4. Strategjia e çmimeve, përveç tjerash, në vete duhet të përfshijë edhe analizën e kushteve të punësimit në regjionin tonë në raport me çmimet dhe shërbimet tona, sa ndikon çmimi njësi i produktit në shpenzimet e tërësishme të amvisërive ose në pagat mesatare të regjionit ku furnizojmë.

Gjithsesi, ujin nuk duhet ta trajtojmë si produkt social, por si kategori ekonomike, e cila për shkaqe të rëndësishme shumë domethënëse për jetesën dhe mirëqenien e popullatës, do të duhej të kishte një vlerësim kushtues adekuat, pra një çmim optimal. Strategjitë e reja duhet të mundësojnë që resurset ujore të ruhen më mirë dhe që ato të shfrytëzohen sa më racionalisht.

V.3. Plani i promovimit të aktiviteteve

Metodologjia e studimit të realizueshmërisë të programit investues kërkon promovim të aktiviteteve nga KRU “Radoniqi” për plasmanin e produktit dhe të shërbimeve, e të cilat do të rendisnim në disa grupe:

1. Marrëdhënia me publikun hynë në aktivitetet shumë të rëndësishme, së cilës KRU “Radoniqi” duhet ti kushtojë rëndësi dhe vëmendje adekuate. Së pari duhet ti identifikojmë dhe grupojmë nevojat dhe kërkesat publike siç janë konsumatorët (aktual dhe potencial), si dhe partnerëve tanë siç janë: furnizuesit, bankat, organet shtetërore dhe komunale të cilat do të informojnë për qëllimet tona investuese. Për këtë me shumë kujdes duhemi të përzgjedhim teknikën, mënyrën dhe formën e marrëdhënies me publikun, siç janë shtypi ditorë, fletushkat, TV dhe format tjera të kontaktimit me publikun.
2. Format e promovimit të investimeve në rritjen e kapacitetit të rritit të ujësllësit dhe kanalizimit duhet ti ndërlihim edhe nga aspekti i sigurisë furnizuese për amvisëri dhe industri me sasinë dhe cilësinë e ujit për pije, mbi ruajtjen e resurseve ujore dhe mbrojtjen mjedisit jetësor përmes grumbullimit të ujërave të përdorura dhe largimin e të njëjtave
